



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER

Nr. 4648 Prot.

Shkodër, më 3103 . ____ . 2023

MARRËVESHJE

E lidhur në Shkodër, sot me datë ____ . ____ . 2023:

Bashkisë Shkodër, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga **Z.Bardh SPAHIA**, në cilesinë e Kryetarit të Bashkisë Shkodër;
dhe

“StyleNet”, është person fizik i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 12.02.2014, me numër NIPT L46412008C, me seli ne adresen Lagjja: Perash, Rr. Daut Boriçi nr. 2, përfaqësuar nga **z. Ezmir Kraja** , identifikuar me dokument identifikues me numer personal I70714115V.

Palet bien dakort si me poshte vijon :

Neni 1
Baza ligjore

Kjo akt-marreveshje lidhet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë :

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,i ndryshuar, neni 9 pika1.2 germa “a”;
- Ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale”;
- Kodi Civil ligji nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar ;
- Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligjin nr.9780, date 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar ;
- Ligjin nr.9918, date 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë ;
- Ligjin nr.107/2014, date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar
- Ligjin 8744, date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajteshme publike të shtetit, njësive të qeverisjes vendore”, i ndryshuar ;
- VKM nr.366 date 27.03.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajteshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkise Shkodër, të qarkut Shkodër”;
- VKM Nr.408, date 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” neni 15, germa “b”;



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER

- VKM nr.155 date 15.03.2006 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut Shkodër”;
- VKB nr.1 date 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar ;
- Udhëzimi nr. 30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

- 2.1** **Bashkia Shkoder** bie dakort që **StyleNet** të realizojë projekte të ndryshme me shtrirje në pronat e paluajtshme publike shtetërore që kanë kaluar sipas legjislacionit në fuqi në pronësi/përdorim të Bashkisë Shkodër, me qëllim mundësinë e ushtrimit të aktivitetit të StyleNet dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente.
- 2.2** **Bashkia Shkodër** deklaron dhe garanton, në respekt të parimit të sigurisë juridike, StyleNet për akses në infrastrukturën aktuale në pronësi/përdorim të bashkisë Shkodër, duke pranuar dhe miratuar projektet e paraqitura nga StyleNet, të cilat lidhen jo vetëm me ndërtimin e një infrastrukture të re rrjeti, por gjithashtu edhe me shfrytëzimin, përdorimin dhe mbështetjen në tubacionet aktuale të Bashkisë, tubacionet e kabllimit të ndricimit, pjese te fasadave, etj, ne pronesi/perdorim të bashkise Shkoder.

Neni 3

Projekti

- 3.1** **Projekti i Ndertimit te Infrastruktures** do t'i bashkelidhet kesaj marreveshje ne fazen kur do të kryhet aplikimi ne sistemin e-albania per Leje Zhvillimi dhe Leje Infrastrukture. Projektet do te permbajne ne menyre te qarte dhe te sakte informacionin mbi parcelen ku do te ndertohet projekti, zonat perkatese kadastrale dhe numrin e pasurise si dhe menyren e shfrytezimit dhe perdorimit te infrastruktures egzistuese te bashkisë Shkodër.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER

- 3.2 Projektet do të shtrihen në bashkinë Shkodër, Njësinë Administrative Qytet Shkodër, Njësinë Administrative Rrethina, Ana e Malit, Bërdice, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Velipojë, Shalë.
- 3.3 Afati për zbatimin e projekteve do të jetë sipas grafikut të punimeve që do të shoqërojë dokumentacionin në sistemin e-albania, me afat 2 (dy) vjeçar.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e StyleNet

- 4.1 "StyleNet" deklaron dhe garanton që të realizojë projektet në përputhje të plotë me:
(a) Legjislacionin e Zbatueshem;
(b) Lejen e Zhvillimit dhe Ndertimit te Infrastruktures qe do leshohet per kete qellim
(c) kete Marreveshje
- 4.2 "StyleNet" merr persiper zbatimin e projekteve ne perputhje dhe respektim te kushteve teknike ligjore dhe konform afateve te percaktuara.
- 4.3 "StyleNet" merr persiper konform kuadrit ligjor ne fuqi, qe ne momentin e paisjes me Leje, te permbushe detyrimin per te njoftuar zyrtarisht Bashkine Shkoder, per fillimin dhe perfundimin e punimeve dhe realizimin e projekteve ne sistemin e-albania.
- 4.4 "StyleNet" deklaron se në perfundim të punimeve që do të kryhen per realizimin e Projekteve, do te riktheje te gjitha siperfaqet ku do te punohet ne gjendjen e tyre fillestare
- 4.5 "StyleNet" deklaron se do të riparoje çdo dëmtim të ardhur në infrastrukture gjatë shfrytezimit te përdorimit, mbështetjen në tubacionet e kabllimit, ndriçimit, pjesë e fasadve në pronesi/perdorim të bashkisë Shkodër.
- 4.6 "StyleNet" ka te drejte te ushtroje te gjitha te drejtat e parashikuara ne kete marreveshje, parashikimet e se ciles jane te vlefshme dhe krijojne pasoja juridike per Palet.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e bashkisë



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER

- 5.1** Bashkia ka të drejtë që, në rast të moszbatimit të kushteve teknike të parashikuara në Lejen e Infrastruktues dhënë për realizimin e projekteve, ose në rast të veprimeve dhe/ose mosveprimeve që vijnë në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm, të urdhërojë ndërprerjen e punimeve dhe të ngarkojë me përgjegjësi materiale për dëmin e shkaktuar.
- 5.2** Në rast të shkeljes së parashikimeve të Leje Infrastruktore dhene nga Bashkia për realizimin e Projekteve, Bashkia ka të drejtë të zbatojë parashikimet e Ligjit Nr.9780, date 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.
- 5.3** Bashkia ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë Marrëveshje, parashikimet e se ciles janë të vlefshme dhe krijojnë pasoja juridike për Palet.

Neni 6
Forca madhore

- 6.1** Asnjë nga palet në këtë Marrëveshje, nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë shkelje të Marrëveshjes në qoftë se ajo shkaktohet nga Forca Madhore. Ngjarje të Forcës Madhore nënkupton çdo rrethësi që nuk është nën kontrollin e pales, pa u kufizuar në:
- (i) Fatkeqesite natyrore, përmytjet, thatësira, termetet apo fatkeqesi të tjera natyrore;
 - (ii) Epidemite ose pandemite;
 - (iii) Sulme terroriste, lufte civile, trazira civile ose rebelime, kërcënime për/ose përgatitje për lufte, konflikte të armatosura, vendosje të sanksioneve, embargo ose prishje e marrëdhënieve diplomatike;
 - (iv) Ndotje berthamore, kimike ose biologjike ose shpërthim zanor;
 - (v) Çdo legjislacion ose masë e marrë nga autoritetet shtetërore ose publike, përfshirë por pa u kufizuar në vendosjen e një kufizimi eksporti ose importi, kuote ose ndalimi;
 - (vi) Rrezim i ndërtesave, zjarr, shpërthim ose aksident, dhe
 - (vii) Çdo mosmarrëveshje pune ose tregtie, greva, masa industriale ose mbyllje të fabrikave (ose me përjashtim të rasteve kur pala kërkuar mbështetet në këtë dispozitë, ose kompanitë brenda të njëjtit grup si pala);
 - (viii) Nderprerje ose mosfunksionin i shërbimeve utilitare;



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER

- 6.2 Pala e prekur nga nje ngjarje e tille do te njoftoje menjehere palen tjeter per shkallen dhe kohezgjatjen e perafert te kesaj pamundesie per te permbushur detyrimet e saj.
- 6.3 Me perfundimin e vonesave ose te humbjeve qe kane rezultuar nga keto ngjarje, pala e prekur do te njoftoje palen tjeter per kete nderprerje.

Neni 7
Të ndryshme

- 7.1 Kjo Marreveshje interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Gjate interpretimit merret ne konsiderate qellimi i synuar i paleve nenshkruese, konteksti i vete Marreveshjes dhe asnje nga palet nuk mund te kufizohet vetem ne kuptimin literal te fjaleve
- 7.2 Palet nuk mund te japin dhe te kalojne ndonje te drejte, sipas kesaj Marreveshje ne teresi ose vecanti pa pasur me pare pelqimin me shkrim te pales tjeter.
- 7.3 Çdo dokument, lajmerim ose njoftim mes Paleve te lidhur ne kete Marreveshje behet me e-mail dhe dergohet me poste
- 7.4 Kjo Marreveshje do te bazohet dhe udhehiqet nga legjislacioni Shqiptar dhe cdo mosmarreveshje, kundershtrim apo pretendim qe rrjedh apo ne lidhje me kete Marreveshje do te zgjidhet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
- 7.5 Palet bien dakort se çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet paleve lidhur me permbajtjen e kesaj Marreveshje, do ti nenshtrohet gjykimit prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, e cila do te jete Gjykata kompetente.
- 7.6 Kjo marreveshje hartohet ne 3 kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, të nënshkruara nga të dyja palet.

Për StyleNet

Përfaqesuar nga administratori

Z. Ezmir KRAJA



Për Bashkinë Shkodër

Kryetar

Z. Bardh SPAHIA

